

Përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime.

<p>Drejtoria/Struktura</p>	<p>Kompetencat dhe detyrat e funksionarëve të lartë të autoritetit publik / procedurat e zgjedhjes/procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime:</p>
<p>Zëvendësministër Drejtore Kabineti Këshilltar</p>	<p>A. Kompetencat dhe detyrat e funksionale: Zëvendësministër</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjek dhe të përgjigjet para Ministrit të Drejtësisë për çështjet në sektorin e antikorruptionit, integritetit evropian dhe zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. • Ndjekë dhe të përgjigjet para Ministrit të Drejtësisë, për çështjet që kanë të bëjnë me jetësimin e reformës në drejtësi, çështjet në sektorin e burgjeve dhe institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, çështjet në sektorin e profesioneve të lira, si dhe në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me shtetet e tjera. <p>Drejtore Kabineti , Këshilltar</p> <ul style="list-style-type: none"> • Struktura e kabinetit mbështet drejtpërdrejt ministrin në ndjekjen e politikave përkatëse, realizimin e objektivave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Mbështet Ministrin e Drejtësisë, në ushtrimin e kompetencave të tij. <p>B. Procedurat e zgjedhjes:</p> <p>Emerim me Vendim të Kryeministrit Emerim me Urdher të Ministrit të Drjtësisë</p>
<p>Sekretar i Përgjithshëm</p>	<p>A. Kompetencat dhe detyrat e funksionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëpërmjet ushtrimit të funksioneve dhe të bashkërendimit të punës së strukturave të institucionit, kujdeset dhe siguron qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e veprimtarive përkatëse të Ministrisë me institucionet e tjera.

	<ul style="list-style-type: none"> Në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligj dhe aktet e tjera nënligjore, si dhe urdhrat ose detyrat e marra nga ministri, Sekretari i Përgjithshëm merr masa për shfrytëzimin e frytshëm të burimeve njerëzore, të mjeteve financiare e burimeve materiale të ministrisë. <p>B. Procedurat e zgjedhjes:</p> <p>Emerim nga DAP sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 118, datë 5.3.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”</p> <p>C. Procedura për të marrë vendime:</p> <p>Në mbështetje të legjislacionit që rregullon veprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë, Legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe financiar; Legjislacionit për nëpunësin civil, procedurat administrative, rregullat e etikës, organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, VKM nr.325, datë 21.05.2003 “Për pozicionin, detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministri”.</p>
<p>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE NË FUSHËN E DREJTËSISË DHE ANTIKORRUPSION</p> <p>Drejtor i Përgjithshëm</p> <p>Drejtor</p>	<p>A. Kompetencat dhe detyrat e funksionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> Realizimi i detyrimeve institucionale të Ministrisë në fushën e drejtësisë në kuadër të integritetit Evropian të Shqipërisë për kriterin politik dhe kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, si dhe për kapitujt e tjerë ku Ministria e Drejtësisë është kontribuese (Kriteri Ekonomik, Kapitulli 4, kapitulli 24 i acquis); Realizimin e detyrimeve institucionale për raportimet periodike, në kuadrin e PKIE, Nënkomiteteve BE-Shqipëri, KSA-se, si dhe çështje të ndryshme që dalin në kuadër të politikave integruese.

- Hartimi i materialeve për procesin e hapjes së negociatave dhe përgatitjen e tyre sipas kërkesave specifike;
- Menaxhimi, raportimi dhe vlerësimi i raporteve të monitorimit të PV të SNAK, duke ia përcjellë strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë;
- Planifikimi, koordinimi, dhe përcaktimi i instrumentave të domosdoshëm për implementimin e politikave të fushës, për zgjidhjen dhe zhvillimin e programeve në fushën antikorrupsionit, si dhe krijimi i bazës së infrastrukturës që do ti paraprijë këtij zhvillimi.
- Vlerësimi i raporteve të Rrjetit AK dhe ato të inspektimeve të kryera nga strukturat që kryejnë inspektimet.
- Hartimi i raporteve të monitorimit të PV të SNAK, duke ia përcjellë strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë;
- Koordinimi i punës së institucioneve me qëllim hartimin e PV dhe të Planeve të Integritetit për zbatimin e SNAK-së;
- Administrimi i sistemit dhe të dhënave të gjeneruara, statistikave dhe raporteve periodike duke përfshirë Track-Recordin antikorrupsion;
- Koordinimi dhe supervizmi i punës së koordinatorëve të rrjetit AK;

B. Procedurat e zgjedhjes:

Emerim nga DAP sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 118, datë 5.3.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

C. Procedura për të marrë vendime:

1. Në mbështetje të legjislacionit që rregullon veprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë, Strategjitë dhe Planet e Veprimit , Legjislacioni në fushën e AK etj,

<p>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KODIFIKIMIT DHE HARMONIZIMIT TË LEGJISLACIONIT</p> <p>Drejtor i Përgjithshëm</p> <p>Drejtor</p>	<p>A. Kompetencat dhe detyrat e funksionale:</p> <p>Përgatitja e mendimeve juridike për projektligjet dhe projektaktet e tjera normative të Këshillit të Ministrave, të ministrive dhe institucioneve qëndrore, si dhe për marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe të Këshillit të Ministrave.</p> <p>Përgatitja, ndjekja, realizimi i politikave dhe veprimtarive që lidhen me hartimin e studimeve në fushën e legjislacionit për drejtësinë, kryerjen dhe përfundimin e analizave tekniko-ligjore të vlerësimit, të efektivitetit të legjislacionit, të procesit legjislativ, si dhe metodologjisë dhe teknikës së hartimit të legjislacionit, harmonizimin tekniko-ligjor të brendshëm të legjislacionit.</p> <p>Përgatitja, ndjekja, realizimi i politikave dhe veprimtarive që lidhen me çështjet e përqasjes dhe të integritetit të sistemit të drejtësisë në nismat dhe strukturat ndërkombëtare përkatëse, si dhe bashkërendimin e punës me institucionet e tjera.</p> <p>B. Procedurat e zgjedhjes:</p> <p>Emerim nga DAP sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 118, datë 5.3.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.</p> <p>C. Procedura për të marrë vendime:</p> <p>Në mbështetje të legjislacionit që rregullon veprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë, Ligji nr.9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; Vendimi nr.584/2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave” etj.</p>

<p>DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE E ÇËSHTJEVE TË DREJTËSISË</p> <p>Drejtor i Përgjithshëm</p> <p>Drejtor</p>	<p>A. Kompetencat dhe detyrat e funksionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet të ndjekë politikat për ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor. Në përputhje me ligjin, të mbështese dhe të bashkërendoje veprimtarinë me organet e pushtetit gjyqësor, prokurorinë dhe institucionet e varesise dhe profesione e lira, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë. • Ushtrimin efektiv dhe profesional të kontrollit dhe përgatitjen e raporteve respektive për të siguruar mbikëqyrjen e respektimit të Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritetit europian nga institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe institucione të tjera; • Rekomandime marrjen e masave të nevojshme për shkeljet e konstatuara gjate kontroleve/monitorimit dhe për shpërndarjen e praktikave të mira. • Propozimin dhe hartimin e politikave që synojnë, në përputhje me ligjin, mbështetjen, bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë me institucionet e varesise dhe profesioneve të lira. • Përgatitjen dhe hartimin e masave konkrete në kuadër të përmirësimit të shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, etj. • Realizimi i bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërmjet organeve gjyqësore shqiptare dhe të huaja në zbatim të Kushtetutës, marreveshjeve

	<p>ndërkombetare, të Ligjit Material e Procedural Penal e Civil.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Realizimin dhe bashkërendimin e veprimtarive në fushën e çështjeve të drejtësisë civile, penale dhe të miturve, për ofrimin e shërbimeve efektive dhe në mbrojtje të të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të njeriut nga organet e sistemit gjyqësor në përputhje me kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë të përcaktuara në legjislacionin e ri të reformës në drejtësi. <p>B. Procedurat e zgjedhjes:</p> <p>Emerim nga DAP sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 118, datë 5.3.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.</p> <p>D. Procedura për të marrë vendime:</p> <p>Në mbështetje të legjislacionit që rregullon veprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë, legjislacioni që rregullon veprimtarinë e Institucioneve të Varësisë dhe Profesionet e Lira, legjislacionit për nëpunësin civil, procedurat administrative, rregullat e etikës, organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore</p>
<p>DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</p> <p>Drejtore i Përgjithshëm</p> <p>Drejtore</p>	<p>A. Kompetencat dhe detyrat e funksionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Koordinimi dhe/ose mbikëqyrja e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, si dhe procedurave të prokurimit dhe partneriteteve në dispozicion të Ministrisë, duke bashkëpunuar me njësitë e tjera organizative, për të garantuar realizimin e misionit të sistemit ministror. • Garantimin e miradministrimit të burimeve njerëzore të sistemit ministror dhe asetëve e shërbimeve të aparatit ministror, me qëllim sigurimin e kushteve për realizimin e misionit,

ushtrimin e kompetencave dhe arritjen e objektivave të Ministrisë.

- Garantimin e cilësinë së planifikimit të buxhetit si dhe mirëmenaxhimin dhe optimizimin e burimeve financiare, për të siguruar kushte për mirëfunksionimin dhe arritjen e objektivave të sistemit të Ministrisë.
- Mbarëvajtjen e procesit të zbatimit të buxhetit sipas legjislacionit përkatës, si dhe optimizimin dhe shpërndarjen e burimeve të nevojshme financiare për realizimin e misionit, ekzekutimin e kompetencave dhe arritjen e objektivave të sistemit ministror.

B. Procedurat e zgjedhjes:

Emerim nga DAP sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 118, datë 5.3.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

C. Procedura për të marrë vendime:

Në mbështetje të legjislacionit që rregullon veprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë, Legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe financiar; Legjislacionit për nëpunësin civil, procedurat administrative, rregullat e etikës, organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore,